

Nr.regj.24903/11

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,me gjyqtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi,duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Virginia Xhavit Dumnica,nga Prishtina, për kundrvajtje nga neni 3 neni 6 neni 7,i sanksionuar me nenin neni 16 paragrafi 1.1.2 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar me Nr.04-L-03/151,e në bazë të neni , 73,74,195,si dhe konform neni 198.al.8 të LMK-së, me dt.**28.01.2013** merrë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurës Virginia Xhavit Dumnica nga Prishtina,rruga“Gazmend Zajmi”nr.6,për kundërvajtje nga neni 3 neni 6 dhe neni 7 i sanksionuar me nenin 16 paragrafi 1.1.2 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe deklarimin,prejardhjen dh kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar nr.03/L-151, e konform neni 198.al.1 pika 8, të LMK-së sepse nuk ka prova të mjaftueshme se e pandehura e ka krye kundervajtjet e përshkruara në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni kundër korrupsionit-në Prishtinë,me kërkesën nr,01-3211/11, të parashtruar gjykatës me dt.19.07.2011,me të cilën i propozohet gjykatës hapjen e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës të lartëcekur,për kundërvajtje nga nenët elartëcekura nga se dyshohet se e pandehura nuk e ka bër deklarimin e rregullt të pasurisë në bazë të funksionit që mban.

Gjyqtari mori në pyetje të pandehurën i cili në deklaratën e saj thekson se nuk e kam deklaruar pasurin pranë Agjencionit Kunder Korrupsionit,nga se për kët obligim timin nuk më ka lajmruar askush.

Gjyqtari mori në pyetje në cilësin e deshmitarit Drita Regjepin, e cili deklaronë se unë nuk kam pasur kurrfar njohitimi për ti lajmruar antaret e Bordit të Komisionit për Ndhim Juridike lidhur me obligimn për deklarimin e psurisë,se përndryshe unë do ta kasha krye një obligim të till.Sa i përket Virginia Dumnicës mendoj se ajo është shumë e përgjegjëshme dhe jam e sigurt se nuk ka pasur njohiri për kë obligim.

Gjyqtari thirri ushtruesin e kërkesës në cilësin e deshmitarit zyrtarën e Agjencionit kunder Korrupsionit,Valbona Zeqirin e cila deklaron se nepëmes imellës agjencioni ka kontaktuar me Arlinda Ndrecaj,dhe pas njohtimit nga ana e saj për zyrtarët e lartë të cilë kanë qenë të obliguar që ta deklarojn pasurinë,e të cilën gjë nuk e kanë berë ne e kemi inicuar procedurën,duke konsiderue se pika kontaktues për ndihm juridike i ka njohtuar zyrtarët e vetë.

Gjyqtari pas degjimit të pandehurës,deshmitarit,ushtruesit të kerkesës,dhe shqyrtimit të shkrasave të lëndes, mori vendim konform neni neni 198.al.1 pika 8 e LMK-së,dhe vendosi si në dispozitiv të ketij aktvendimi,nga se nuk ka prova të mjaftueshme se e pandehura e ka krye kundervajtjen,sepse nuk është njohtuar nga askush se e ka obligim për deklarimin e pasurisë.

Duke u bazuar në të gjitha këto gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi palët mund të ushtrojn ankesë Gjykatës së Apeli-Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjës së këtij aktvendimi nëpërmjet kësaj Gjykate pa taksa.

Gjyqtari

Murat Paçarada

